

Tetor - Dhjetor 2011

## PERMBAJTTJA

### Faqe 1

- Tryeza e rrumbullakët: “Drejtësia në Drejtësi?!”

### Faqe 2

- Aplikimi i buxhetimit me pjesëmarrje në komunat e Kosovës
- Takime publike për fuqizimin e rolit të rinjëve në skenën politike në Kosovë

### Faqe 3

- Punëtori për avokim me organizatat e shoqërisë civile të regionit të Gjilanit
- Trajnime të organizuara për organizatat partnere të Forum Syd.

### Faqe 4

- Takim informativ për thirrjen për propozime nga EIHDR
- “Ambasadorët e Vegjël” në mbrojtje të mjedisit
- Peticion kundër dhunës në familje

### Faqe 5

- Trajnim për Kryqin e Kuq: “Zhvillimi i komunitetit për pjesëmarrje”
- ATRC monitoron procesin e kthimit të të zhvendosurve nga vendet e treta.

## “Drejtësia në Drejtësi”?!

**- Efikasiteti në ndjekjen penale të korrupsionit –**

**- Mbikqyrja efektive e akterëve të drejtësisë për parandalimin e korrupsionit -**

Organizuar nga ATRC dhe PILPG në kuadër të projektit të përbashkët: Drejtësia dhe qytetarët, i cili përkrahet nga Qeveria Amerikane, përkatësisht Departamenti Anti-drogë, anti-trafikim dhe sundim të ligjit në Uashington, më datë 27 tetor 2011 organizuan tryezën e tretë me radhë të ekspertëve të fushës së Sundimit të Ligjit me temën: **“Drejtësia në Drejtësi”?!**  
**- Efikasiteti në ndjekjen penale të korrupsionit – Mbikqyrja efektive e akterëve të drejtësisë për parandalimin e korrupsionit.**

Për të diskutuar rreth dy temave bosht të tryezës, ishin ftuar për të marr pjesë përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës, përfaqësues të Organizatave të shoqërisë civile, ekspertë të fushës së drejtësisë etj, si: Presidentja e Republikës së Kosovës: znj. Atifete Jahjaga, këshilltari i Ministrisë së Drejtësisë z. Vigan Qorolli, drejtori i Agjencisë Antikoorupsion z. Hasan Preteni, z/v prokurori i Qarkut të Prishtinës z. Lulzim Sylejmani, ish z/v ombudspersoni i Kosovës z. Hilmi Jashari, Luan Hasanaj, drejtor i Rrjetit Rinor të Kosovës, Petrit Zogaj nga Lëvizja FOL etj.



Presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga në fjalën e saj përshëndetëse ndër të tjera tha: *“Krijimi i një gjyqësie transparente, të depolitizuar, të pa-korruptuar dhe të përgjegjshme ndaj secilit qytetar është nxitje dhe standard për të fituar besimin e palëkundshëm në institucionet e drejtësisë. Ndërtimi dhe reformimi i vazhdueshëm i sistemit të drejtësisë është synimi i përpjekjeve tona për të ndërtuar shtet të mundësive të barabarta, ku sundon ligji dhe zbatimi i tij”, tha Presidentja Jahjaga*

Ndërkaq, Kushtrim Kaloshi, drejtor i ATRC në fjalën e tij të hapjes, sqaroi qëllimin e organizimit të tryezës, si dhe arsyen e përcaktimit të dy temave bosht të saj. *Përmes kësaj tryeze synojmë t’i japim përgjigje temës boshte, e cila është shtruar edhe si pyetje dhe njëkohësisht si sugjestion: Drejtësia në drejtësi?! A kemi drejtësi në drejtësi? Sa kemi drejtësi në drejtësi? A mund të sigurojmë drejtësi në drejtësi? Si mund të sigurojmë drejtësi në drejtësi? Kush është përgjegjës për të siguruar drejtësi në drejtësi? Çfarë roli mund të luajnë qytetarët në sigurimin e drejtësisë në drejtësi, si të mbrohet drejtësia nga padrejtësitë në drejtësi, dhe pyetje tjera të ngjashme të cilat imponohen për trajtim dhe njëkohësisht presin përgjigje.*

Informatori: **The Advocate**, është publikim i ATRC-së, i cili synon të informojë organizatat joqeveritare, donatorët, mediat, përfaqësuesit e institucioneve etj, për aktivitetet e zhvilluara në ATRC dhe nga partnerët e saj. Shpresojmë dhe urojmë që publikimi do të jetë në funksion të informimit dhe koordinimit më të mirë të aktiviteteve në mes ATRC-së dhe organizatave të tjera joqeveritare në Kosovë. Publikimi është bërë i mundur falë gatishmërisë dhe vullnetit të stafit të ATRC-së.

## APLIKIMI I BUXHETIMIT ME PJESËMARRJE NË KOMUNAT E KOSOVËS

Në kuadër të projektit “Zgjidhja e konfliktit social”, të financuar nga Olof Palme International Center, ATRC ka publikuar udhëzuesin për procesin e buxhetimit me pjesëmarrje. Udhëzuesi përmban shembuj dhe rekomandime për komunitet dhe organizatat e shoqërisë civile e qytetarët rreth aplikimit të buxhetimit me pjesëmarrje.

Ky dokument, i përgatitur nga ATRC është rezultat i punës së punëtorëve të organizuar me përfaqësuesit e Shoqërisë Civile dhe zyrtarët komunal të 11 komunave të Kosovës, në të

cilat punëtorët janë dhënë rekomandime konkrete rreth hapave që duhet të ndërmerren komunitet me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në vendimarrje, që nga faza e planifikimit të buxhetit komunal deri në implementimin e tij.



Udhëzuesi i është shpërndarë falas zyrtarëve komunal dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Me qëllim të publikimit të dokumentit, ATRC në bashkëpunim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun të Kuvendit Komunal të Prizrenit, më 23 dhjetor 2011 ka organizuar konferencë për media.

Në konferencë, përveç përfaqësuesve të ATRC-së morën pjesë edhe drejtori i Drejtorisë komunale për Financa, zyrtari për Informim i Komunës së Prizrenit, përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe media lokale, si: TV Prizreni dhe TV Opinion të cilat kanë transmetuar më pas në kuadër të emisionit të lajmeve.

## TAKIME PUBLIKE PËR FUQIZIMIN E ROLIT TË TË RINJËVE NË SKENË POLITIKE NË KOSOVË

ATRC në partneritet me Organizatën Qendra për Hulumtime Kualitative dhe me përkrahje nga Fridrich Ebert Stiftung, ka mbajtur tri takime publike në Gjakovë, Gjiilan dhe në Ferizaj për fuqizimin e rolit të të rinjve në skenën politike.

Përmes këtyre takimeve publike është synuar që me të rinjtë nga subjektet politike, anëtarët e forumeve rinore të partive politike, të rinjtë nga organizatat e shoqërisë civile, zyrtarët për rini nga institucionet komunale, studentët, media lokale dhe anëtarë të qendrave rinore të diskutohet rreth pjesëmarrjes së të rinjve dhe rolit të tyre në skenën politike. Njëkohësisht gjatë këtyre takimeve është prezantuar edhe hulumtimi “Fuqizimi i rolit të të rinjve në skenën politike në Kosovë”.

Takime të tilla janë planifikuar të organizohen edhe në 5 qendrat tjera të Kosovës, si: Prizren, Pejë, Mitrovicë, Skenderaj dhe Rahovec.



## PUNËTORI PËR AVOKIM ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE TË REGJIONIT TË GJILANIT

Në kuadër të projektit “Drejtësia dhe Qytetarët”, ATRC, në bashkëpunim me partnerin implementues PILPG, më datë 11 nëntor 2011 në Gjilan kanë mbajtur punëtorinë e dytë me radhë në avokim dhe dhunë në familje.

Në trajnim ishin ftuar të merrnin pjesë përfaqësues të organizatave joqeveritare të komunave të regjionit të Gjilanit, të cilat merren me çështje gjinore, përfaqësues të komunave të regjionit të Gjilanit, media lokale etj.

Qëllimi i punëtorisë ishte ngritja e kapaciteteve avokuese të përfaqësuesve të OSHC-ve në çështje që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit në përgjithësi, hartimin e rekomandimeve për politikat publike të cilat lidhen me çështjen gjinore në përgjithësi, negociimi me zyrtarët qeveritar dhe avokimi në parandalimin e dhunës në familje dhe barazinë gjinore në veçanti. Deri me tani janë mbajtur dy punëtori të këtij lloji, e para në Prishtinë dhe e dyta në Gjilan, ndërkohë që do të vazhdohet me organizimin e punëtorive edhe në komunën e Pejës dhe të Prizrenit.



## TRAJNIME TË ORGANIZUARA PËR ORGANIZATAT PARTNERE TË FORUM SYD

ATRC ka vazhduar bashkëpunimin me Programin: Forum Syd, rreth ngritjes së kapaciteteve të organizatave joqeveritare, përfituese të këtij programi. Gjatë kësaj periudhe në sallën e trajnimeve të ATRC-së janë mbajtur 5 trajnime/punëtori, nga të cilat kanë përfituar 13 përfaqësues të organizatave joqeveritare rinore.

Punëtoritë janë përqendruar në ofrimin e metodave dhe praktikave të nevojshme për menaxhimin dhe zhvillimin organizativ të OJQ-ve; principet e udhëheqjes së OJQ-ve, funksionet dhe përgjegjësitë, llogaridhënien, transparencën dhe kodin etik; ngritjen e fondeve, planifikimin strategjik, marrëdhëniet me publikun dhe barazinë gjinore.



### TAKIM INFORMATIV PËR THIRRJEN PËR PROPOZIME NGA EIHDR

ATRC në bashkëpunim me Projektin për Asistencë Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile (TACSO) me qëllim të mbështetjes së OSHC-ve të Kosovës në aplikimin për thirrjen për propozime EIDHR, me datë 3 nëntor 2011 ka mbajtur takim informativ me organizatat e shoqërisë civile të regjionit të Prishtinës. Takimi ishte organizuar me qëllim të informimit të OSHC-ve për thirrjen e hapur për propozime të EIDHR, përkatësisht sqarimin e objektivave, rregullave për aplikim dhe kërkesës së thirrjes në përgjithësi.

Në takim kanë marr pjesë rreth 120 organizata të shoqërisë civile të regjionit të Prishtinës, një numër prej të cilave u janë nënshtruar një trajnimi profesional për procedurat dhe kriteret e aplikimit.



### “AMBASADORËT E VEGJËL” NË MBROJTJE TË MJEDISIT

Në kuadër të projektit të mbështetur nga Ambasada Amerikane “Ambasadorët e vegjël të mjedisit”, ATRC gjatë muajit tetor dhe nëntor, 2011 organizoi 4 TV emisione mjedisore me nxënës të klasave të V-ta në katër komuna të ndryshme të Kosovës: Prizren -TV Opinioni, Mitrovicë - TV Mitrovica, Viti - TV Iliria dhe Prishtinë - KTV.

Mysafir në TV emisione ishin përfaqësuesit e ATRC dhe nxënësit e shkollave ku janë mbajtur ligjëratat për mjedisin, të cilët gjatë intervistës patën mundësi që angazhimet e tyre rreth mbrojtjes së mjedisit brenda dhe jashtë objektit shkollor dhe vizionin e tyre për një mjedis më të shëndetshëm ti ndajnë me shikuesit. TV emisionet kishin për qëllim informimin e shikuesve për gjendjen mjedisore në shkollat fillore të komunave të ndryshme në Kosovë si dhe ngritjen e vetëdijes së tyre për tu angazhuar aktivisht në mbrojtjen e mjedisit si obligim qytetar i secilit.

### PETICIONI KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

ATRC dhe PILPG në kuadër të projektit të përbashkët: Drejtësia dhe qytetarët, më datë 12 dhjetor 2011 kanë organizuar aksionin për mbledhjen e nënshkrimeve nga qytetarë dhe kalimtarë të rastit në Sheshin Nënë Terezë, kundër dhunës në familje. Ky aksion ka qenë i organizuar në kuadër të fushatës së iniciuar nga Agjencioni për Barazi Gjinore i Qeverisë së Kosovës.

Brenda dy ore janë arritur të mblidhen më shumë se 200 nënshkrime nga qytetarë, të cilat më pas do t'i përcillen policisë së Kosovës, me kërkesën që viktimat e dhunës në familje të informohen për të drejtat dhe mundësitë që kanë në sistemin e drejtësisë.



## TRAJNIM PËR KRYQIN E KUQ; “Zhvillimi i komunitetit me pjesëmarrje”

ATRC me datën 7 dhe 8 dhjetor 2011, mbështetur nga Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq Ndërkombëtarë, mbajti trajnimin “Zhvillimi i komunitetit me pjesëmarrje” për 30 koordinatorët e Kryqit të Kuq të Kosovës. Trajnimi kishte qëllim që t’i ngrisi kapacitetet e koordinatorëve të Kryqit të Kuq në çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin e komunitetit, respektivisht përgatitjen e tyre që kjo qasje të aplikohet në punën e përditshme të tyre me komunitetin. Gjatë dy ditëve, sa zgjati trajnimi, pjesëmarrësit u informuan rreth: si të identifikohen dhe prioritarizohen nevojat e komunitetit; sa është e rëndësishme pjesëmarrja e komunitetit në procesin e zhvillimit të komunitetit, nivelet e pjesëmarrjes; si të bëhet vlerësimi dhe monitorimi me pjesëmarrje dhe cilat mjete duhet të përdoren.

### ATRC MONITORON PROCESIN E KTHIMIT TË TË ZHVENDOSURVE NGA

ATRC në partneritet me UNHCR edhe gjatë këtij viti vazhdon me monitorimin e procesit të të kthyrve nga vendet e treta. ATRC aktualisht ka të angazhuar 4 monitorues në Aeroportin e Prishtinës, të cilët në koordinim të ngushtë me Policinë e Kosovës, përfaqësinë e UNHCR-it në Kosovë dhe Aeroportin e Prishtinës, intervistojnë dhe grumbullojnë të dhënat e nevojshme për të gjitha rastet e kthimit të Kosovarëve nga vendet e treta, qoftë kthim vullnetar ose i detyruar. Të dhënat e grumbulluara ATRC në vazhdimësi i përcjell në zyrën qendrore të UNHCR-it.

[www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org)

#### MISIONI I ATRC-së

ATRC është organizatë kosovare, jo-ftimprurëse e cila synon rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në përgjithësi dhe shoqërisë civile në veçanti në proceset vendimmarrëse përmes ofrimit të shërbimeve dhe bashkëpunimit aktiv me palët me interes në vend dhe jashtë tij si një nga kushtet themelore për një shoqëri të zhvilluar dhe demokratike.

#### PROGRAMET KRYESORE TË ATRC

1. Programi i ngritjes së kapaciteteve, i cili synon që përmes trajnimeve dhe ofrimit të konsulencave, të rrisë kapacitetet e organizatave joqeveritare në Kosovë në fushën e zhvillimit të përgjithshëm organizativ, menaxhimit të projekteve, zhvillim të fushatave të suksesshme të avokimit etj.
2. Programi i administrimit të granteve, i cili synon të ndihmoj organizatat joqeveritare lokale përmes granteve të vogla kryesisht në fushata avokimi në nivel lokal dhe nacional.
3. Programi për Avokim, përmes projekteve të ndryshme ATRC synon të avokoj në institucione nacionale dhe lokale për probleme të ndryshme të cilat janë preokupim dhe brengë e qytetarëve në përgjithësi.
4. Informimi, përmes të cilit ATRC synon të ofrojë informacione në mënyrë elektronike në ueb faqe, në lidhje me diskutimet publike dhe tryeza të rumbullakëta, ndërtimet e koalicioneve, ndërmjetësim partneriteti dhe bashkëpunimi. ATRC, gjithashtu në kuadër të kësaj komponente ofron librari me 1756 tituj të ndryshëm, si: botime për çështjet sociale, politike dhe ekonomike që lidhen me Kosovën dhe rajonin, analiza, studime, hulumtime dhe dokumente tjera me rëndësi mbi fushëveprimtarinë e organizatave joqeveritare në përgjithësi, të krijuara nga organizata joqeveritare brenda dhe jashtë Kosovës.

ADVOCACY TRAINING & RESOURCE CENTER - ATRC

Rr. GAZMEND ZAJMI NR.20 PRISHTINË,

PHONE/FAX: +381(0)38 244810

E-MAIL: [info@advocacy-center.org](mailto:info@advocacy-center.org)

web page: [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org)